



raporti i **MONITORIMIT** PËR PUNËN E KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM

Raporti numër 6

(periudha e raportimit:
15 dhjetor 2019 – 15 mars 2020))

Skopje 2020

АКЦИЈА ЗА ПОГОЛЕМА
транспарентност,
отчетност и ефективност
 на **СУДСКИОТ**
СОВЕТ НА РМ



Институт за човекови права

Projekti:

Aksion për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet më të madh të Këshillit Gjyqësor të RMV

Implementues:

Instituti për të Drejtat e Njeriut



Ky publikim është hartuar në kuadër të Projektit: “Aksion për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet më të madh të Këshillit Gjyqësor të RMV”, i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Opinionet dhe qëndrimet e prezantuara në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë çdoherë opinionet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.

Raporti i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor të RMV

Hyrje

Raporti i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor, për periudhën kohore nga 15 dhjetori i vitit 2019 deri në 15 mars të vitit 2020, u hartua në kuadër të projektit “Aksion për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet më të madh të Këshillit Gjyqësor”¹, ndërkaq intencë e tij është matja e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të Këshillit Gjyqësor.

Instituti për të Drejtat e Njeriut synon që në mënyrë më të lehtë dhe gjithëpërfshirëse ta vlerësoj transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e punës së Këshillit Gjyqësor përmes pjesëmarrjes në mbledhjet publike, ndjekjes së ueb-faqes të Këshillit Gjyqësor dhe qasjes së lirë deri te informacionet me karakter publikë.

Ky Raport – monitorimi përmban informacione:

Për nevojat e monitorimit u shfrytëzuan këto burime të informacioneve: pjesëmarrja në të gjitha mbledhjet e hapura të Këshillit Gjyqësor, përgjigje ndaj kërkesave të parashtruara për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publikë, ueb-faqja e Këshillit Gjyqësor të RM, publikime në media etj.

TRANSPARENCA NË PUNËN E KËSHILLIT GJYQËSOR

Përmbajtja e ueb-faqes

Biografi të anëtarëve të KGJRM	✓
Akresi i informacioneve për mbledhjet e mbajtura	✓
Publikimi i shpalljeve për zgjedhjen e gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave dhe të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve	✓
Publikimi i emrave të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve	✓
Publikimi i biografive të kandidatëve për zgjedhje të anëtarit të Këshillit Gjyqësor	✗
Reagime dhe komunikata për publikun që kanë të bëjnë me sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit	✓
Raporte tremujore dhe vjetore për punën e gjykatave	✓
Statistikë relevante për gjyqësorin	✗
Analiza	✗
Vendime sipas procedurave të përsëritura për përgjegjësinë e gjyqtarit (sipas aktgjykimeve të GJEDNJ)	✗

1 <http://www.ihr.org.mk/project.php?pid=357>

Analiza e përmbajtjes së publikimeve të Këshillit Gjyqësor dhe deklaratave për media:

- Këshilli Gjyqësor, në periudhën e raportimit, në masë të konsiderueshme e rriti aktivitetin e tij përmes publikimit të rregullt të reagimeve dhe komunikatave deri te publiku në lidhje me ngjarjet aktuale të cilat ndikojnë mbi pavarësinë e gjyqësorit.² Për dallim nga e kaluara, Këshilli Gjyqësor adreson reagime deri te publiku, jo vetëm për çështje të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt ndërlidhen me angazhimin e tyre të përditshëm, por reagon edhe ndaj publikimeve në media, ndaj deklaratave të prokurorëve dhe avokatëve me të cilat sulmohet puna dhe pavarësia e gjyqësorit, dhe e gjithë kjo në drejtim të mbrojtjes së gjyqësorit dhe potencimit të punës së pavarur. Në mënyrë që informacionet e rëndësishme të arrijnë deri te opinioni më i gjerë, rekomandohet që Këshillit Gjyqësor reagimet/komunikatat e tij, tua dërgoj edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë gazetarëve, me qëllim të përafrimit me qytetarët dhe me publikun e gjerë.
- Komunikatat për mbledhjet e mbajtura janë publikuar rregullisht dhe në kohë të duhur në ueb-faqen e Këshillit. Komunikatat që janë publikuar për vendimet e miratuara pas çdo mbledhje janë bërë në kohë të duhur dhe përmbajnë informacione më të detajuara nga ato paraprake.

Llogaridhënia në punën e Këshillit Gjyqësor të RMV

Raportin për vitin 2019, Këshilli Gjyqësor duhet ta aprovoj dhe ta miratoj më së voni deri më 30 prill të vitit 2020, pasi të përpilohen dhe miratohen raportet e veçanta vjetore të gjykatave. Të njëjtin do t'ia paraqesë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Këshilli Gjyqësor e miratoi dhe publikoi Planin e Veprimit për vitin 2020.³ I njëjti i përmban aktivitetet e njëjta të parashikuara me Planin e Veprimit nga viti paraprak. Në Raportin vjetor për vitin 2019, Këshilli Gjyqësor duhet ta arsyetojë punën e kryer, të parashikuar me Planin e Veprimit për punën e atij viti.

Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të RMV, për vitin 2018, i cili në kohë të duhur iu paraqit Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, deri në përfundimin e kësaj periudhe të raportimit, nuk ka informacione se i njëjti është miratuar. Miratimi i Raportit nga Kuvendi është jashtëzakonisht i rëndësishëm, meqë sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor, pas miratimit të tij, Këshilli Gjyqësor këtë Raport ua dërgon të gjitha gjykatave. Nëse Kuvendi nuk e miraton Raportin, kjo do të jetë bazë për një mbledhje të organeve që i kanë zgjedhur anëtarët e Këshillit Gjyqësor (gjyqtarë dhe Asambleja) për ta shqyrtuar dhe vlerësuar punën e tyre.⁴

EFEKTIVITETI I KËSHILLIT GJYQËSOR

Zgjedhja e anëtarit të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve

Si kandidatë për anëtarë të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve, të cilët u përkasin bashkësive, u paraqitën Artan Limani (gjyqtar në Gjykatën Civile Shkup) dhe Hanif Zendeli (gjyqtar në Gjykatën e Apelit Gostivar). Pas përcaktimit të listës së kandidatëve, Këshilli Gjyqësor i publikoi emrat e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor përmes një komunikate të posaçme.

Disa ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, kandidati Artan Limani e revokoi kandidaturën e tij. Në përputhje me dispozitat e reja ligjore, zbatimi i zgjedhjeve është në kompetencë të Komisionit për Realizimin e Zgjedhjeve të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve (Komisioni për zgjedhje). Në dispozitat ligjore që janë në fuqi nuk është përcaktuar në mënyrë të saktë se si duhet të vepohet kur kandidati e revokon kandidaturën e tij pas përcaktimit të listës së kandidatëve, kështu që, në përputhje me dispozitat e tjera, me të cilat rregullohet procesi i zgjedhjes së anëtarit në KGJRMV, Komisioni për zgjedhje, revokimin e kandidatit nuk e ka pranuar,

2 <http://www.sud.mk/wps/portal/ssrm>

3 Programi i punës (Plani i Veprimit) për vitin 2020.

4 Neni 100, paragrafi 7 dhe 8, Ligji për Këshillin Gjyqësor, "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.102/2019.

meqë lista e kandidatëve tanimë ka qenë e miratuar. Rrjedhimisht me këtë, Këshilli Gjyqësor nuk e publikoi revokimin e kandidaturës së njërit nga kandidatët, kështu që procesi i zgjedhjes u zhvillua duke i votuar të dy kandidatët, edhe atë më datë 22 janar të vitit 2020.

Kryetari i Këshillit Gjyqësor deklaroi se në atë fazë kandidati nuk ka pasur mundësi ta revokojë kandidaturën e tij, megjithatë ka pasur mundësi të paraqesë dorëheqje, nëse i njëjti zgjidhej si anëtar, me ç'rast e gjithë procedura do të përsëritej. Megjithatë, për revokimin e kandidaturës kanë ditur një pjesë e gjyqtarëve, dhe kjo ndoshta ka ndikuar në vendimin e tyre se cilit kandidat do t'ia japin votën e tyre.

Në bazë të sublimimit dhe përcaktimit të rezultatit të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga radhët e gjyqtarëve, pjesëtarë të bashkësisë e cila është më shumë se 20% nga popullata e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që u mbajt më datë 22.1.2020, nga gjithsej 494 gjyqtarë të regjistruar në Regjistrin zgjedhor gjyqësor, votuan 466 gjyqtarë. Të pavlefshme ishin 37 fletëvotime, ndërsa fletëvotime të papërdorura ishin 28.

Kandidatët i fituan votat si vijon:

Artan Limani – 190 vota

Hanif Zendeli – 239 vota

Nga rezultatet e konstatuara përfundimtare, për anëtar të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve të cilët i përkasin bashkësisë e cila është më shumë se 20% nga popullata në Republikën e Maqedonisë së Veriut, u zgjodh Hanif Zendeli, gjyqtar në Gjykatën e Apelit në Gostivar.

Sipas Ligjit të ri për Këshillin Gjyqësor, Komisioni për zgjedhje i sublimon rezultatet nga vendet zgjedhore dhe e përcakton rezultatin e zgjedhjeve në njësitë zgjedhore më së voni në afat prej 48 orësh nga momenti i mbylljes së zgjedhjeve dhe e ka për detyrë, përmes ueb-faqes së Këshillit, të siguroj që publiku në kohë reale ta ndjek sublimimin e rezultatit zgjedhor, dhe nëse nuk mund të sigurohet transmetim i drejtpërdrejtë për shkaqe teknike, atëherë e ka për detyrë të siguroj regjistrim dhe më së voni ditën e ardhshme regjistrimin ta postoj në ueb-faqen e tij.⁵ Transmetim të drejtpërdrejtë nuk ka pasur, ndërsa regjistrimi nuk është i aksesshëm në ueb-faqen e Këshillit, për shkak të mungesës së resurseve njerëzore dhe teknike që një gjë e këtillë të realizohet.

Zgjedhja e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave

Zgjedhja e gjyqtarëve në gjykatat themelore

Gjyqtar në Gjykatën Themelore fillimisht zgjidhet nga kandidatët e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Vetëm nëse nuk ka kandidat të paraqitur nga Akademia, atëherë Këshilli mund të zgjedhë gjyqtar nga ndonjë gjykatë tjetër themelore i cili është paraqitur në konkurs.⁶

Në këtë periudhë kohore u zgjodhën 13 (trembëdhjetë) gjyqtarë në gjykatat themelore të RMV, kandidatë të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë nga gjenerata e fundit, edhe atë:

- për gjyqtar në Gjykatën Themelore Manastir u zgjodh Dragan Jakovlevski, kandidat nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

- për gjyqtare në Gjykatën Themelore Kumanovë u zgjodh Aleksandra Nakovska, kandidate nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

- për gjyqtare në Gjykatën Themelore Kumanovë u zgjodh Arbenita Ismani Sakipi, kandidate nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

- për gjyqtare në Gjykatën Themelore Penale Shkup u zgjodh Ana Velkovska, kandidate nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

- për gjyqtare në Gjykatën Themelore Penale Shkup u zgjodh Tamara Vitlarova Smilevska, kandidate nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

5 Neni 25, paragrafi 1, Ligji për Këshillin Gjyqësor, "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.102/2019.

6 Neni.47, Ligji për Këshillin Gjyqësor, "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.102/2019.

- për gjyqtare në Gjykatën Themelore Penale Shkup u zgjodh Imrane Selmani, kandidate nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.
- për gjyqtare të Gjykatës Themelore Civile Shkup u zgjodh Suzana Dimitriev, kandidate nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.
- për gjyqtare të Gjykatës Themelore Civile Shkup u zgjodh Lupka Kërçinska Stevkova, kandidate nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.
- për gjyqtare të Gjykatës Themelore Civile Shkup u zgjodh Tamara Gjorgjievaska, kandidate nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.
- për gjyqtar në Gjykatën Themelore Tetovë u zgjodh Elvedin Ferati, kandidat nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.
- për gjyqtare në Gjykatën Themelore Shtip u zgjodh Marina Zdravkova, kandidate nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.
- për gjyqtare në Gjykatën Themelore Ohër u zgjodh, Aleksandra Pop Stefania, gjyqtare në Gjykatën Themelore Negotinë.
- për gjyqtare në Gjykatën Themelore Sveti Nikole u zgjodh Liljana Dodevska, gjyqtare në Gjykatën Themelore Radovish.

Në konkursin për gjykatat themelore në Berovë, Vinicë, Gostivar, Dellçevë, Kërçovë dhe Krushevë nuk ka kandidatë të paraqitur nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë dhe as gjyqtarë nga gjykatat e tjera themelore.

Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve të lartpërmendur, përveç kriterëve ligjore, për herë të parë u zbatua edhe Rregullorja për mënyrën e rankimit të kandidatëve për gjyqtarë nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë në të cilën është specifikuar mënyra e rankimit të kandidatëve nga lista e kandidatëve, e dërguar nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë që janë paraqitur për zgjedhje të gjyqtarit në gjykatë themelore.

Në vendimet e zgjedhjes është e aksesshme rank-lista e kandidatëve, me numrin e pikëve të fituara nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë dhe me numrin e pikëve të fituara nga intervista e realizuar nga Këshilli Gjyqësor. Megjithatë, pikët nga intervistat nuk janë të specifikuara dhe nuk është i aksesshëm procesverbali i veçantë nga intervistat e realizuara. Arsyetimi për kandidatin e zgjedhur nuk përmban të dhëna për intervistën, por i referohet vetëm përvojës paraprake të kandidatit, edhe pse në këtë rast intervista ka rol vendimtar në rankimin e kandidatëve.

Zgjedhja e gjyqtarëve në gjykatë më të lartë

Zgjedhja e gjyqtarëve në Gjykatën Supreme

Në mbledhjen e 332 të KGJRMV të datës 10.2.2020, u zgjodhën edhe gjyqtarë në Gjykatën Supreme të RMV. Fillimisht u zgjodhën gjyqtarë në Gjykatën Supreme të RMV, pas dy konkurseve, nga të cilët i pari në shtator dhe i dyti në nëntor të vitit 2019. Në kuadër të dy konkurseve, duhej të zgjidheshin gjithsej 6 gjyqtarë, nga të cilët 2 në fushën penale dhe 4 gjyqtarë në fushën civile. Zgjedhja e këtyre gjyqtarëve u realizua në përputhje me risitë ligjore të miratuara në maj të vitit 2019 dhe Rregulloren për mënyrën e rankimit të kandidatëve për zgjedhje të gjyqtarit në gjykatë më të lartë, kështu që për gjyqtarë në KGJRM u zgjodhën:

- Mirjana Lazarova Trajkovska, në fushën penale, ish-gjyqtare në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.
- Safet Kadrii, në fushën penale, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkup.
- Nake Georgiev, në fushën civile, kryetar aktual i Gjykatës së Apelit Shtip.

- Lidija Martinova, në fushën civile, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkup,

Dy vendet e tjera nuk u plotësuan, meqë kandidatët nga rank-lista (gjithsej 8) nuk e fituan shumicën e nevojshme të pikëve nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor të RMV, pa u dhënë ndonjë arsyetim pse këta kandidatë nuk janë adekuat që të bëhen gjyqtarë të GJSRMV, ndërkaq ekziston nevojë e madhe për plotësimin e vendeve vakante për gjyqtarë në këtë gjykatë, veçanërisht duke i pasur parasysh procedurat e iniciuara për përgjegjësinë e gjyqtarëve pikërisht nga kjo gjykatë.

Zgjedhja e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Shkup

Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut i duhej më shumë se një vit që të zgjedh gjashtë gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Shkup. Përfundimisht më datë 10.2.2020, në përputhje me kriteret e vjetra për zgjedhje sipas ligjit i cili ishte në fuqi në kohën e publikimit të konkursit për zgjedhje, u zgjodhën 3 gjyqtarë nga fusha penale, 2 gjyqtarë nga fusha civile dhe 1 gjyqtar nga fusha ekonomike. Edhe pse konkursi disa herë ishte pikë e rendit të ditës, zgjedhja e kandidatëve prolongohej.

Numri i përgjithshëm i kandidatëve të paraqitur në këtë konkurs është 95, edhe atë:

- 28 kandidatë në fushën penale;
- 40 kandidatë në fushën civile;
- 27 kandidatë në fushën ekonomike.

Zgjedhja e kandidatëve u realizua në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjet e vjetër për gjykata dhe Këshillin Gjyqësor. Për çdo fushë u përgatitën 2 rank-lista edhe atë një rank-listë mazhoritare dhe një minoritare.

Gjyqtarë të zgjedhur në Gjykatën e Apelit Shkup janë:

Gjyqtarë nga fusha penale:

- Lidija Zimbovska-Gjykata Themelore Penale Shkup
- Gjoko Ristov – Gjykata Themelore Penale Shkup
- Jusuf Ajrullahi – Gjykata Themelore Penale Shkup

Gjyqtarë nga fusha civile:

- Violeta Popovska – Gjykata Themelore Civile Shkup
- Ariton Alla – Gjykata Themelore Civile Shkup

Gjyqtarë nga fusha ekonomike:

- Petranka Tasheva – Gjykata Themelore Strumicë

Zgjedhja e këtyre kandidatëve iu nënshtrua monitorimit mediatik dhe dilemave në lidhje me justifikimin e zgjedhjes, meqë kandidatët e zgjedhur nuk ishin të rankuarit e parë të listës. Kandidatët nuk ishin as të rankuarit e fundit, megjithatë mungonte justifikimi me të cilin do të bindet publiku se janë përzgjedhur kandidatët më adekuatë për atë vend të gjyqtarit.

Zgjedhja e kryetarëve të gjykatave

Për kryetar të gjykatës zgjidhet gjyqtari i cili nga rank-lista e kandidatëve do të fitoj numër më të madh të votave nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor (më së paku tetë anëtarë të Këshillit me të drejtë vote). Çdo anëtar i Këshillit, me të drejtë vote, e ka për detyrë në mënyrë verbale, në mbledhje të Këshillit, ta arsyetojë vendimin e tij për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës.

Vendimet për zgjedhje janë publikuar në ueb-faqe.

Kandidati për kryetar të gjykatës, fletëparaqitjes dhe dokumenteve tjera ua bashkëngjiti programin e punës gjatë mandatit, i cili detyrimisht duhet të përmbajë parametra të matshëm dhe korniza kohore për realizimin e qëllimeve programore sipas viteve kalendarikë.⁷

U zgjodhën kryetarë të gjykatave në Strugë dhe Kavadar

- Kryetar i Gjykatës në Strugë u zgjodhe Ifet Bajramoski
- Kryetar në Gjykatën e Kavadarit u zgjodh Lazar Nanev

U miratuan vendime për përcaktimin e UD – kryetarë edhe atë:

- Vendim për përcaktimin e ushtrueses së detyrës – kryetare e Gjykatës së Apelit Manastir për Liljana Çoçkovska, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Manastir;

- Vendim për përcaktimin e ushtruesit të detyrës – kryetar i Gjykatës Themelore Koçan për Zoran Gligorov, gjyqtar në Gjykatën Themelore Koçan; dhe

- Vendim për përcaktimin e ushtruesit të detyrës – kryetar i Gjykatës Themelore Ohër, për Vullnet Vinca, gjyqtar në Gjykatën Themelore Ohër.

Shkarkimi i gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave

Në këtë periudhë kohore u miratua vendimi me të cilin një gjyqtar është shkarkuar për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit dhe përkohësisht është suspenduar nga ushtrimi i funksionit.

U miratuan disa vendime sipas raporteve të komisioneve për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit/kryetarit të gjykatës, me të cilat një pjesë e procedurave pezullohen, ndërsa për disa raporte të tjera janë kërkuar plotësime.

Në mbledhjen e Këshillit Gjyqësor, të mbajtur më datë 17.2.2020, për shkak të zgjedhjeve të caktuara të parakohshme parlamentare në muajin prill, u miratua qëndrimi kolektiv i anëtarëve të Këshillit që të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarëve/kryetarëve të gjykatave të pezullohen.

Vendimet për shkarkimin e gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës të cilët janë miratuar paraprakisht, nuk janë publikuar, me arsyetimin se afatet e ankimimit nuk kanë skaduar.

Në të vërtetë, për një pjesë të vendimeve afatet e ankimimit qëmoti ishin të skaduara, vetëm Gjykata Supreme akoma nuk i kishte trajtuar të njëjtat. Gjykata Supreme, në mbledhjen e mbajtur në muajin mars, e konfirmoi vendimin e Këshillit Gjyqësor për shkarkimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të RMV.

Raporte tremujore për punën e gjykatave

Në muajin mars janë shqyrtuar dhe miratuar raportet për punën e gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut për tremujorin e IV të vitit 2019, edhe atë për: Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykatën e Lartë Administrative, Gjykatën Administrative, juridiksioni i apelit Shkup, juridiksioni i apelit Manastir, juridiksioni i apelit Gostivar dhe juridiksioni i apelit Shtip.

7 Neni 47, Ligji për gjykata;

Komunikatat nga mbledhjet në të cilat janë shqyrtuar raportet tremujore, nuk janë të detajuara, përkatësisht nuk njoftohet se cila gjykatë është azhure ose joazhure. Informacioni ka formë informative, përkatësisht se në mbledhje janë shqyrtuar dhe miratuar raportet e gjykatave.

Raportet publikohen në pjesën "raporte" pa sqarime narrative për gjendjen e gjykatave. Raportet përmbajnë vetëm tabela me numrin e lëndëve të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura dhe ngjashëm.

Parashtresa deri te Këshilli Gjyqësor

Këshilli Gjyqësor rregullisht i trajton parashtresat dhe ankesat e qytetarëve dhe personave juridikë për punën e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave. Megjithatë, pjesa më e madhe e tyre janë refuzuar si të pabaza, meqë sipas Këshillit Gjyqësor, parashtruesit në të njëjtat kanë prezantuar pretendime ankimore të cilat janë pjesë të procedurave gjyqësore.

Një pjesë e madhe e parashtresave refuzohen si të pabaza, nëse procedura gjyqësore është në rrjedhë e sipër. Në rastet kur anëtarët e Këshillit Gjyqësor do të vendosin që të sigurojnë të dhëna plotësuese si dhe të shqyrtojnë fakte plotësuese për veprimin e gjyqtarit ose të kryetarit të gjykatës, në bazë të ndonjë parashtrese, ata vendosin që kjo parashtresë të shqyrtohet në njërin nga mbledhjet e ardhshme por, megjithatë, jo çdoherë arsyetohet kontinuiteti i këtyre procedurave, dhe as ajo se cilat fakte shtesë janë konstatuar që të miratohet vendimi përkatës i Këshillit Gjyqësor. Gjatë shqyrtimit të procedurave të cilat janë në procedurë ankimore, ose për të cilat tanimë është deklaruar gjykata më e lartë, Këshilli Gjyqësor vendos se janë të pabaza, meqë Këshilli Gjyqësor nuk ka të drejtë të vendos për pretendime ankimore. Megjithatë, në këto raste Këshilli Gjyqësor nuk i vlerëson as pretendimet dhe provat për të cilat nuk ka vendosur gjykata më e lartë, por të cilat janë theksuar në parashtresë dhe kanë të bëjnë me pavarësinë dhe paanshmërinë e punës së gjyqtarit. Këshilli Gjyqësor mund të inicioj edhe procedurë për përgjegjësinë e gjyqtarit, nëse vlerëson ushtrim të pandërgjegjshëm të funksionit. Nga ana tjetër, që të konstatohet ushtrim i pandërgjegjshëm i funksionit, është e domosdoshme të vlerësohen të gjitha aspektet e procedurës dhe të merret parasysh aktgjykimi.

Me ndryshimet e reja ligjore ekziston mundësia për iniciimin e procedurës për përgjegjësi të gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës e cila mund të paraqitet edhe nga qytetarët, dhe prandaj gjithnjë e më i madh është numri i kërkesave të parashtruara direkt për iniciimin e procedurës për përgjegjësinë e gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës. Së këtejmi, në krahasim me vitin 2018, kur janë paraqitur kërkesa për përcaktimin e përgjegjësisë kundër 10 gjyqtarëve, në vitin 2019 janë paraqitur kërkesa për përcaktimin e përgjegjësisë kundër 131 gjyqtarëve ose kryetarëve të gjykatave.

Shqyrtimi i detajuar i parashtresave dhe përgjigjja të cilën Këshilli Gjyqësor ua jep palëve për bazueshmërinë dhe pabazueshmërinë e parashtresës janë tejet të rëndësishme për rikthimin e besimit të qytetarëve në këtë organ.

Akte të miratuara nënligjore

Këshilli Gjyqësor, edhe pse pas skadimit të afatit, i miratoi aktet nënligjore në përputhje me Ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor.

Rregullorja e punës së Këshillit Gjyqësor të RMV, pas korrigjimeve përkatëse dhe vërejtjeve të bëra në mbledhjen në të cilën shqyrtohej, u miratua unanimisht.

Rregullorja për mënyrën e rankimit të kandidatëve për gjyqtarë nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë dhe Rregullorja për mënyrën e rankimit të kandidatëve për zgjedhje të gjyqtarit në gjykatë më të lartë, u miratuan unanimisht. Megjithatë, para se të miratohet e njëjta, u debatua rreth mënyrës së njoftimit të kandidatëve në lidhje me atë se si do të zbatohet e njëjta dhe a do të vlejë për procedurat tanimë të filluara, me qëllim që të gjithë kandidatët të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Metodologjia lidhur me kompleksitetin e lëndëve akoma nuk është miratuar dhe e njëjta, sipas informacioneve nga Këshilli Gjyqësor, është në fazë të hartimit.

Instituti për të Drejtat e Njeriut përgatiti aplikacion për celular, për monitorimin e punës së Këshillit Gjyqësor. Aplikacionin mund ta shkarkoni FALAS në Google Play Store dhe në Apple Store me emrin "Institucione nën thjerrëz". Këtu do t'i gjeni të gjitha informacionet aktuale dhe raportet tremujore në kuadër të projektit "Aksion për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet më të madh të Këshillit Gjyqësor të RM-së".

